



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 50 prot

Laç, më. 05 . 01 .2024

Lënda : Njoftim për shpallje vende të lira pune (vetëm NC) ,niveli ulët drejtues, Bashkia Kurbin.

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

Adresa: Bulevardi "B.Curri" pranë ish-Hotel "Arbana"

TI RANË

Mbështetur në nenin 9 pika (b) dhe nenin 64 pika (g) e Ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", neni 26 (të ndryshuar), Vendimin Nr.39, datë 19.12.2023 të Këshillit Bashkiak, "Për miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin, Njësisë dhe Institucioneve në varësi për vitin 2024", Vendimin nr.40, datë 19.12.2023 të Këshillit Bashkiak, "Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit të vendeve të punës në Bashki dhe Institucionet e varësisë për vitin 2024", Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.219 datë 28.12.2023 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kurbin, Institucioneve dhe Agjensive në varësi dhe klasat e pagave për Nëpunësit Civile në Bashki dhe Njësitë Administrative për vitin 2024", si dhe Vendimin Nr.242, datë 18.03.2015 të Këshillit Bashkiak, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", Kreu II pika 2 dhe Kreu III, pika 2, Bashkia Kurbin shpall njoftimin për procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë në kategorinë e nivelit të ulët drejtues të administratës, në pozicionin :

➤ "Përgjegjës Sektori", tek Sektori i Strehimit Social, Drejtoria e Shërbimeve Publike

Shpallja është e hapur vetëm për nëpunësit civile, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil, të së njëjtës kategori (për procedurën e lëvizjes paralele) dhe të një kategorie paraardhëse (për procedurën e ngritjes në detyrë, nëse nuk ka patur asnjë të përzgjedhur nga procedura e lëvizjes paralele).

Njoftimi për sa më sipër, do t'ju niset edhe me E-mail, në adresën: vendetelirapune@shkp.gov.al

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Majlinda ÇARA



Adresa: Lagjia Nr.3, Laç,

Tel.0532 22 270 Fax +355 5322 225

E-mail bashkia_lac@yahoo.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 50/11 prot

Laç, më. 25.01.2024

NJOFTIM PËR VEND PUNE

“Për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë në nivelin e ulët drejtues për plotësimin e vendit të lirë të punës në Administratën e Bashkisë Kurbin”

Në zbatim të Ligjit Nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, neni 22 dhe neni 26; VKM Nr.242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira, në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” Kreu II dhe Kreu III, Bashkia Kurbin shpall *procedurën e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë* të kategorisë III-a/1 për vendin e punës në pozicionin :

➤ **“Përgjegjës Sektori”, tek Sektori i Strehimit Social, Drejtoria e Shërbimeve Publike**

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civilë të kategorisë së nivelit të ulët drejtues, në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

I -Lëvizja paralele :

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv;

Kërkesa të veçanta për këtë vend pune janë :

- Arsim të lartë të nivelit DND/DIND/Master Shkencor; Juridik
- Të ketë përvojë pune me shume se 1 vit ne administraten publike;
- Zoterimi nje gjuhe te huaj BE, (përbëjnë avantazh);
- Kryerja e kualifikimeve të ndryshme ,brenda fushes (përbëjnë avantazh)
- Të njohe e perdore shume mire programet baze ne kompjuter,
- Të zotërojë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi me goje/shkrim, i hapur ndaj çdo sfide, me aftësi pershtatjeje ndaj ndryshimeve per transferimin e personelit, si dhe aftësi për të punuar në grup.
- Paga e pozicionit, kategoria :III-a/1.

II- Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

“Përgjegjës Sektori”, tek Sektori i Strehimit Social, Drejtoria e Shërbimeve Publike

- Identifikon nevojat për strehim, sipas programeve të hartuara në bazë të ligjit në fuqi për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre;
- Harton programe afatshkurtëra dhe afatgjata për strehimin dhe projekte bazuar në burimet financiare;
- Paraqet kërkesat pranë ministrit që mbulon fushën e strehimit, për financime, investime dhe subvencione;
- Krijon dhe administron, në nivel vendor, bazën e të dhënave për familjet që përfitojnë strehim;
- Përcakton kostot maksimale të lejueshme, brenda kufijve të përcaktuar nga ministri që mbulon fushën e strehimit, për ndërtimin e banesave, sipas këtij ligji;
- Siguron ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira;
- Njofton çdo vit ministrin që mbulon fushën e strehimit, për ecurinë e programeve të strehimit, sipas këtij ligji;
- Administron kërkesat për përfitimin nga programet sociale të strehimit dhe cakton përparësitë; përgatit dokumentacionin e nevojshëm për miratimin e tyre me vendim të këshillit të Bashkisë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe;
- Asiston këshillin në miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e familjeve përfituese;
- Siguron informacion të plotë, të lehtë për t'u gjetur, të kuptueshëm dhe të lexueshëm, edhe nga persona me mungesë shikimi për llojin e programit social të strehimit që zbatohet në Bashkinë Kurbin, kushtet që duhet të plotësojnë subjektet e interesuara për t'u përfshirë në programin specifik të strehimit; dokumentacionin që kërkohet për verifikimin e të dhënave që deklaron subjekti i interesuar; dhe procedurën që do të ndiqet nga Bashkia për miratimin e përfituesve;
- Garanton transparencë në procesin e përzgjedhjes së përfituesve, nëpërmjet publikimit të sistemit të pikëzimit dhe vënies në dispozicion, për të interesuarit që nuk janë përzgjedhur, të tabelës përmbledhëse të pikëzimit të të gjithë aplikantëve;
- Ndihmon për plotësimin e formularëve të aplikimit për strehim për personat me mungesë shikimi, për ata që nuk kuptojnë gjuhën shqipe apo ata që nuk dinë shkrim e këndim, si dhe siguron që edhe grupe a individë, që kanë vështirësi komunikimi, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore apo sociale, të marrin informacionin e nevojshëm për këtë qëllim;
- Administron dhe mirëmban banesat sociale me qira duke zbatuar standardet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

III- Dorëzimi dokumenteve :

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokoll-Arkivit

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- Një kopje të jetëshkrimit (CV);
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- Fotokopje e diplomës (e noterizuar), nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit;

- Fotokopje e diplomës me listën e notave (të noterizuar), nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Vërtëtim të gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje të një vlerësimi vjetor;
- Aktin e emërimit si nëpunës civil;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje të kartës së identitetit.

Ky dokumentacion duhet të dorëzohet nga kandidati deri në **datën 10.01.2024**.

IV-Rezultatet për verifikimin paraprak të kushteve minimale të procedurës lëvizje paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifike të vendit të punës do të dalin në datë **12.01.2024** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Institucionit dhe në stendën e informimit të publikut. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 3 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

Konkurrimi-Intervista me gojë do të zhvillohet në ambientet e Bashkisë Kurbin (salla e mbledhjeve) në datën **15.01.2024, ora 10.00**.

V/1-Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Ligjin Nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”(i azhornuar);
- Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit interesit”(i ndryshuar);
- Rregulloren e Brendshme të Bashkisë

V/2-Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshëm**, ngritur pranë Bashkisë Kurbin, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë për dokumentacionin** e dorëzuar i ndarë: 10 pikë për vlerësimin e jetëshkrimit (CV), 10 pikë për eksperiencën, 5 pikë për trajnimet, 10 pikë për kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse (organizimi dhe zhvillimi i zgjedhjeve), 5 pikë për vlerësimet pozitive.
- b. **60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;**

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin ku ka konkurruar si: **“Përgjegjës Sektori”, tek Sektori i Strehimit Social, Drejtoria e Shërbimeve Publike**, në administratën e Bashkisë Kurbin. Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 23 Kreu II të Vendimit të Këshillit të Minstrave nr.242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

V/3-Lista e fituesve do të shpallet në datën 17.01.2024. Njoftimi do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Institucionit dhe në stendën e informimit të publikut, në datën 17.01.2024.

B- Procedura të ngritjes në detyrë :

- Nese Komisioni i Brendshëm përfundon procedurën e *lëvizjes paralele pa asnjë të përzgjedhur*, rinis procedura nëpërmjet *procedurës së ngritjes në detyrë*. Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, në të gjithë institucionet pjesë e shërbimit civil.
- Dokumentet dorëzohen nga nëpunës civilë të një kategorie më të ulët, që plotësojnë minimalisht kushtet sipas pikës 2, të Kreut III Të VKM nr.242, datë 18.03.2015, në zyrën e Protokoll-Arkivit 22.01.2024 të Bashkisë Kurbin.
- Në datën 26.01.2024, do të shpallet lista e verifikimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të Institucionit dhe në stendën e informimit për publikun. Keta do të jenë ata që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme e të vecanta , të kërkuara *më sipër*.Ankesat nga kandidatet paraqitën në Njesinë Përgjegjëse, brenda 5 diteve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.
- *Konkurrimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë* , me datë 30.01.2024 Ora 10⁰⁰ , Salla Mbledhjeve në Bashki.
- *Faza e vlerësimit me procedure e ngritjes në detyrë*, me totalin e pikëve prej *100 pikë*, është e strukturuar si vijon :
 - a)20 pikë për dokumentacionin,
 - b)40 pikë për vlerësimin me shkrim,
 - c)40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë.
- *Data e daljes së rezultateve të konkurrimit me procedurë e ngritjes në detyrë:*
 - *Lista e fituesve* me mbi 70 pike (mbi 70% te pikeve) ,do të shpallet datë 02.02.2024.
 - *Njoftimi do të bëhet:* në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Institucionit dhe në stendën e informimit tek publikut, në datën 02.02.2024.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në adresën: Bashkia Kurbin email bashkiakurbin@gmail.com

DREJTORE E BNJ
JURGENA TUCI

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
PASHK KACI